



KAÇANIKU



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	23.01.2019	Vendi	KAÇANIK
Nr. org.	02	Nutari	60/01-2193 / 19
		Shtojcë	

INFORMATË RRETH PËRMBUSHJES SË PLANIT TË
INTEGRITETIT TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN
2018

JANAR 2019

Përmbajtja

HYRJE.....	3
PJESA E PARË, PROKURIMI PUBLIK, MENAXHIMI FINANCIAR DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE.....	4
Prokurimi Publik.....	4
Menaxhimi Financiar.....	4
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore.....	5
PJESA E DYTË, INTEGRITETI DHE TRANSPARENCA E PËRGJITHSHME, DEKLARIMI I PASURISË DHE KONFLIKTI I INTERESIT.....	7
Integriteti dhe Transparenca e Përgjithshme.....	7
Deklarimi i Pasurisë.....	8
Konflikti i Interesit.....	8
PJESA E TRETË, ADMINISTRA E PËRGJITHSHME, KABINETI I KRYETARIT DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN.....	9
Administrata e Përgjithshme.....	9
Kabineti i Kryetarit.....	10
Marrëdhëniet me Publikun.....	10
Përfundim.....	11

HYRJE

Kosova që nga përfundimi i luftës të vitit 1999, e ka përcjellë një mori ndryshimesh, e që përfshijnë edhe konsolidimin e një shoqërie moderne e demokratike, për të cilën gjenerata të tëra kanë derdhur gjak e janë sakrifikuar në çfarëdo mënyre. Në këtë kontekst, ne të zgjedhurit e popullit në mënyre demokratike e gjithashtu të gjithë shërbyesit civil e publik, jemi të vetëdijshëm se për të arritur objektivat që na i lanë të parët, duhet të sakrifikojmë veten me punë e mund të pandalshëm, në mënyre që gjeneratave të ardhshme t'ju krijojmë mirëqenie, prosperitet dhe mbi të gjitha një shtet demokratik të integruar në instanca më të larta të organizatave demokratike botërore.

Natyrisht që në bazë të Kushtetutës së Republikës të Kosovës, sistemi qeverisës ndahet në dy nivele; qendror dhe lokal. Pa dashur që të bëjmë krahasime, duhet të themi që hapi i parë që qytetarët takohen me pushtetin për të realizuar të drejtat e tyre janë institucionet lokale, në këtë rast komuna.

Komunat e Kosovës, pa veçuar as Kaçanikun, janë faktor shumë të rëndësishëm lidhur me formimin e shtetit. Komunat i kanë paraprirë shumë proceseve si ai i decentralizimit me anë të së cilit është synuar që shërbimet të delegohen aty ku duhet të qytetari. Për të mos u zgjeruar shumë kronologjikisht me ngjarjet që kanë ndodhur, duhet të themi që në institucione që organizohet puna me qytetar, rreziku i shpërfaqjes së dukurive negative është shumë më i madh se diku tjetër.

Dihet se dukuritë negative siç janë; korrupsioni, nepotizmi, burokracia, si dhe shumë dukuri tjera, janë shndërruar në barrën më të madhe të cilën ne si shoqëri dhe institucione duhet ta luftojmë. Me qëllim të parandalimit dhe zhdukjes së këtyre dukurive negative, Komuna e Kaçanikut në bashkëpunim me UNDP, ka aprovuar planin e integritetit në dhjetor të vitit 2016, me të cilin kemi identifikuar fushat e rrezikut të cilat kërkojnë të kihet vëmendje. Rrjedhimisht, me qëllim të luftimit dhe çrrënjësjes një herë e mirë të këtyre dukurive të sipërshënuara dhe njëkohësisht ngritjen e integritetit të komunës dhe besueshmërisë së qytetarëve ndaj nesh, në dhjetor të vitit 2018 kemi përpiluar plan të ri. Në fakt, këtij plani u janë shtuar edhe disa fusha të reja të rrezikut të cilat ne si bartës të institucionit duhet t'i qasemi shumë seriozisht.

Kjo informatë në formë raporti, parasheh gjendjen reale se ku gjendemi sot si institucion, cilat ishin masat që kemi ndërmarrë, dhe cilat janë rezultatet që i kemi arritur dhe sa jemi të kënaqshëm me to për vitin 2018.

Konform planit të kaluar, në vazhdim do të raportojmë për tri fusha esenciale të cilat janë baza e funksionimit të mirëfilltë komunal. Këto fusha i kemi ndarë në tri pjesë; pjesa e parë përbëhet nga prokurimin publik, menaxhimin financiar si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore; pjesa e dytë me integritetin dhe transparencën e përgjithshme, deklarimin e pasurisë si dhe konfliktin e interesit; pjesa e tretë dhe e fundit me administratën e përgjithshme, kabinetin e kryetarit dhe marrëdhëniet me publikun.

PJESA E PARË, PROKURIMI PUBLIK, MENAXHIMI FINANCIAR DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Prokurimi Publik

Në kuadër të prokurimit publik, si sektor shumë i rëndësishëm i raporteve mes komunës dhe operatorëve ekonomik, gjithnjë me qëllim të udhëheqjes së procedurave tenderuese tek investimet kapitale apo mallrave dhe shërbimeve, me planin e integritetit kemi vërejtur si fushë të rrezikut potencial “mungesën e kontrollit dhe transparencën e dobët”.

Nëpërmjet krijimit të mekanizmave ligjor si dhe ngritjes së kontrollit të vazhdueshëm të udhëheqësit më të lartë administrativ të komunës, kemi arritur që të gjitha njoftimet, kontratat, dhe prokurimet e ndryshme t’i bëjmë transparente.

Ky fakt dëshmohet nga realiteti që përgjegjësit e zyrës së prokurimit i publikojnë njoftimet vazhdimisht në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë Qendrore të Prokurimit (<https://e-prokurimi.rks.gov.net/Home/ClanakItemNeë.aspx> si dhe në ueb-faqen zyrtare <https://kk.rks.gov.net/kacanik/category/prokurimi/?page=2018>¹.

Plani i punës së zyrës së prokurimit si dhe bashkëpunimi në mes të drejtorive dhe sektorëve brenda komunës, i kanë kontribuar rritjes së performancës si dhe respektimin e procedurave lidhur me prokurimin publik. Andaj, mbi këto fakte konfirmohet premisë e mirë se është krijuar baza e të qenit transparent dhe kontroll esencial lidhur me parimet e konkurrencës së lirë dhe çmimeve më të favorshme.

Gjatë vitit 2018, janë udhëhequr në mënyrë të suksesshme mbi 30 procedura tenderuese për projekte kapitale, të cilat falë respektimit të ligjeve dhe planit të integritetit, kanë dëshmuar që interesi publik dhe ngritja e integritetit të komunës është në radhë të parë, dhe si e tillë, do të duhej të vazhdohej edhe viteve në vijim. Me fjalë tjera, investimet kapitale duke respektuar konkurrencën e lirë midis operatorëve ekonomik si dhe çmimit më të favorshëm për komunën, u garantohet qytetarëve të Komunës së Kaçanikut se mirëqenia dhe kontrolli mbi paranë publike është faktor i fuqishëm rreth ngritjes së besueshmërisë ndaj nesh.

Plani i prokurimit për vitin 2018 është krijuar konform nevojave të qytetarëve. Meqenëse janë alokuar nga Ministria e Financave rreth 300,000.00 € shtesë për mallra dhe shërbime, prokurimi ka tejkaluar planin e paraparë, dhe ka udhëhequr procedura transparente të cilat kanë qenë mëse të duhura për ne.

Qëllimi kryesor i yni është që të vazhdohet me këtë ritëm rreth përmirësimit të vazhdueshëm të fushës së prokurimit publik, duke bërë që të eliminohen rreziqet potenciale të cilat eventualisht do ta denigronin imazhin të cilin e kemi krijuar tek qytetarët falë përkushtimit tonë.

Menaxhimi Financiar

Promotori kryesor me anë të së cilës realizohet misioni dhe objektivat e komunës janë financat publike. Ashtu siç përmendëm tek prokurimi publik, të gjitha fushat e

¹ Linqet e qasura më: 10/01/2019

rrezikut të cilët i kemi ndarë në tri pjesë në këtë informatë janë të ndërlidhura si “hallkë zinxhirore” me qëllim të vetëm; zhvillimin e komunës.

Me planin e kaluar në menaxhimin financiar, si fushë të rrezikut kemi identifikuar “planifikimi i buxhetit dhe menaxhimi i të hyrave nuk është efikas”. Ne, gjatë vitit 2018, kemi arritur që me sukses të aplikojmë masa shtesë të cilat kanë treguar rezultat efektiv sa i përket menaxhimit të mirë të financave publike. Planifikimi i buxhetit për vitin 2018, ka arritur si rrjedhojë e analizave të cilat ishin kërkesa të qytetarëve si dhe nuk janë bërë në asnjë formë dallime shoqërore, partiake etj. Duke arritur që nëpërmjet dëgjimeve publike të cilat kanë qenë të hapura për të gjithë qytetarët, kemi vë prioritetet për investimet kapitale, të cilat në mënyrë të suksesshme janë përfunduar gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportojmë.

KATEGORIA EKONOMIKE	VITI: 2017	VITI: 2018
Paga dhe meditje	4,831,215	4,854,390
Mallra dhe shërbime	539,350	705,037
Shpenzime Komunale	139,000	139,000
Subvencione & transfere	204,690	204,690
Investime Kapitale	1,325,026	1,660,103
TOTAL FINANCIMI	7,039,281	7,563,220

Tab.1 Planifikimi i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve

Siç mund ta shihni tabelën e mësipërme, kategorisë së investimeve kapitale i kemi dhënë rëndësinë e duhur duke e rritur atë për 335,077.00 €. Investimet kapitale janë kategori e cila prek çdo qytetar dhe si e tillë është trajtuar nga ne me prioritet të plotë. Priorizimi i kësaj fushe do të thotë që synimi ynë është përmbushja e planit të integritetit në formën më të mirë, dhe besojmë fuqishëm që jemi në rrugë të drejtë.

Efikasitetin në të hyra dhe menaxhim të financave e forcon përkushtimi, bashkëpunimi në mes drejtorive si dhe respektimi i parasë publike nga Komuna e Kaçanikut. Shtrirja e investimeve kapitale në çdo cep të Kaçanikut, njëkohësisht ofrimi i shërbimeve komunale për çdo qytetar pa dallim, janë motivi i punës së përditshme të cilën ne e bëjmë në koordinim me grupet e ndryshme të interesit, shoqërinë civile, partitë politike etj.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Njëri ndër kuptimet e qeverisjes së mirë është arritja e kapacitetit të mjaftueshëm i institucionit për të menaxhuar burimet e veta, për të zbatuar politika të përshtatshme, si dhe aplikimin e masave të kontrollit demokratik mbi shërbyesit civil. Në këtë kontekst, burimet njerëzore janë pikërisht ata të cilët i shtyjnë proceset përpara. Menaxhimi i mirë i burimeve njerëzore ndër tjerash, është kusht që shpien drejt reformave në administratën publike. Këto reforma tash e një kohë kërkohen edhe nga BE-ja.

Menaxhimi i burimeve njerëzore në Komunën e Kaçanikut zhvillohet nëpërmjet zyrës së personelit- e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit. Në planin e integritetit tek menaxhimi i burimeve njerëzore si fushë të rrezikut kemi paraqitur se “procedurat e rekrutimit nuk janë transparente si dhe mungon verifikimi i kualifikimeve”. Me qëllim të përmbushjes së planit për vitin 2018, i kemi dhënë rëndësinë e duhur çështjes së transparencës rreth rekrutimeve. Gjithashtu të gjitha fletë-dëshmitë e kualifikimeve të kandidatëve për pune janë verifikuar nëpërmjet SIMBNJ-së.

Gjatë vitit 2017, nga auditori i jashtëm nuk është theksuar asnjë e gjetur për zyrën e personelit. Këtë të arritur, e kemi aplikuar me përkushtim e punë edhe në vitin 2018, ku jemi përkushtuar në procedurat e rekrutimit, të cilat i kemi bërë transparente aq sa ligji na ka lejuar.

Në anën tjetër, më qëllim të ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, Komuna e Kaçanikut nëpërmjet zyrës së personelit, ka arritur t'i informojë shërbyesit civil për trajnimet të cilat janë zhvilluar. Kështu që gjatë vitit 2018 janë mbajtur 23 trajnime të përfshirë mbi 40 zyrtar komunal. Koordinimi i zyrës së personelit me ekzekutivin ishte mjaft i suksesshëm, si rrjedhojë e prezantimit të Ligjit për Shërbyesit Civil si dhe Rregulloret tjera, nuk është zhvilluar asnjë procedure disiplinore. Këto fakte japin garancë se Komuna e Kaçanikut-zyra e personelit, qëndron fuqishëm në misionin e saj që përmes planit të integritetit të asistojë në implementimin transparencës në proceset rekrutuese.

PJESA E DYTË, INTEGRITETI DHE TRANSPARENCA E PËRGJITHSHME, DEKLARIMI I PASURISË DHE KONFLIKTI I INTERESIT

Integriteti dhe Transparenca e Përgjithshme

Qeverisja komunale i ka dhënë prioritet tash e sa vite, ngritjes së imazhit dhe transparencës komunale. Megjithatë, në bazë të planit të integritetit e kemi veçuar "mungesën e integritetit për funksionim transparent dhe efikas të komunës" si fushë potenciale e rrezikut me anë të së cilës do të dëmtohej imazhi i komunës. Në këtë drejtim janë ndërmarrë masa duke i dhënë integritetit komunal rëndësinë e duhur me ç'rast është përpiluar plani i integritetit. Me qëllim të përmbushjes së planit në fjalë, komuna ka ndërmarrë hapa konkret si: respektimin e kodit të etikes, orarit të punës, kodit të veshjes, mirësjelljen etj.

Komuna si njësi e vetëqeverisjes lokale, ofron shërbime ndaj kërkesave të qytetarëve të cilat parashihen me ligj. E përderisa ekziston vendi ku qytetaret duan t'i përmbushin të drejtat e tyre paqetë që duhet të krijojmë mekanizma të ndryshëm që i japin komoditetin e duhur lidhur me ofrimin e shërbimeve.

Integriteti dhe transparenca janë dy komponent të rëndësishëm që shërbejnë si masë treguese lidhur me performancën komunale në nivel të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës nëpërmjet MAPL-së, ka krijuar Sistemin për Menaxhimin e Performancës së Komunave (SMPK). Ndër fushat themelore për të cilat bëhet matja e performancës së komunave është transparenca. Në këtë segment, Komuna e Kaçanikut qëndron mjaft mirë. Në fund të vitit 2018, Kaçaniku së bashku me disa komuna tjera është shpallur fitues e grantit të performancës për vitin 2017 (84,138.00 €), gjithashtu komuna jonë ka përfituar grantin prej 104.268,00 € për vitin fiskal 2019, mjete këto që do të shfrytëzohen në investime kapitale në qytet. Kushtet minimale për tu kualifikuar për këtë grant ishin opinioni pozitiv i auditimit të jashtëm dhe se paku 75% e buxhetit për investime kapitale të jetë i shpenzuar. Ndër tri fusha për të cilat kemi qenë në garë, te fusha e tretë – transparenca dhe integriteti jemi vlerësuar me pikë maksimale, 13 pikë nga 13 të mundshme (100%).

Ekzekutivi i komunës, ka aplikuar formën e pjesëmarrjes në gara në nivel vendi e që njëra ndër to është kjo e sipërshënuar. Motivi ishte që të shohim se ku qëndrojmë në raport me komunat tjera si dhe të identifikojmë dhe mënjanojmë pengesat të cilat do të na e cenonin integritetin. Për vitin 2018, kemi arritur që të përmbushim planin dhe të reagojmë në fushën potenciale të rrezikut duke u angazhuar që "të qenit transparent do të thotë të qeverisesh me parime demokratike", ku gjithsecili është dëshmitar i punës dhe i veprimeve që ndërmarrim në situata të caktuara. Vlen të përmendim që në fushën e transparencës dhe integritetit kemi arritur që të rangohemi shumë më lart se mesatarja në Republikën e Kosovës, dhe ky fakt na motivon neve që të vazhdojmë drejt përmirësimit të dukshëm në të qenurit transparent kundrejt qytetarit.

Deklarimi i Pasurisë

Funksionet e larta të zyrtarëve komunal, shpeshherë shihen si target potencial i grupeve të ndryshme të interesit, që kërkojnë me çdo kusht t'i kryejnë shërbimet e ndryshme në mënyrë të ndryshme (jologjore), duke përfutur nga pozita dhe afërsia që kanë me ta. Në të kaluarën në Kosovë, jo rrallë herë ka ndodhur që zyrtarët të marrin shuma të mëdha parash për punët që kanë qenë të obliguar në bazë të detyrave të punës t'i kryejnë duke dëmtuar palët. Me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka formuar Agjencinë Kundër Korrupsionit. Kjo agjenci, ndër tjerash qëllimin kryesor e ka mbikëqyrjen dhe kontrollin e zyrtareve publik rreth pasurisë dhe të ardhurat e tyre.

Padyshim që për shoqërinë e cila vazhdimisht është në tranzicion, është mekanizëm i kontrollit mbi zyrtaret publik, të cilët nuk duhet që jashtëligjshëm të pasurohen duke bërë dëm ndaj të tjerëve. Sidoqoftë as Komuna e Kaçanikut nuk ka qëndruar duarkryq në këtë çështje. Nëpërmjet deklarimit në afat ligjor të pasurisë në AKK që bëhet nga funksionarët përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit Komunal, për vitin 2018 i kemi kushtuar rëndësi të veçantë. Asnjë rast i mospërfutjes së të dhënave apo raste korruptive nuk është iniciuar, andaj fushën e rrezikut të cilin në planin e integritetit që është përkufizuar "rregullat e brendshme në lidhje me deklarimin e pasurisë nuk ekzistojnë" e kemi neutralizuar. Masat e ndërmarra në këtë drejtim ishin njoftimi i të gjithë stafit politik lidhur me rreziqet e mos deklarimit të pasurisë në afat të paraparë kohor.

Konflikti i Interesit

"Konflikti i interesit është situata e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, ku zyrtari ka interes privat, direkt ose indirekt, që ndikon, mund të ndikojë ose duket sikur ndikon në realizimin e gabuar të funksionit publik, në situata të shkeljes së mundshme të parimeve, të kufizimeve apo detyrimeve të tjera zyrtare". Në mbështetje të këtij përkufizimi, synimet në bazë të planit të integritetit për vitin 2018, ishin që zyrtarët të njoftohen me situatat kur mund të shfaqet konflikti i interesit.

Deklarimi i pasurisë dhe konflikti i interesit me qëllim janë përzgjedhur si tema të cilat përfshihen në këtë informatë, ngase në mënyrë të drejtpërdrejt ndikojnë në ngritjen e integritetit komunal. Me përkushtim dhe aftësi ndërvepruese lidhur me këtë çështje, fatmirësisht nuk kemi pasur asnjë rast të konfliktit të interesit në institucionin komunal për vitin 2018.

Vazhdimisht jemi në interes të përkushtimit në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve të cilat si rezultat kanë ngritjen e integritetit komunal. Për këtë, deklarimin e pasurisë përsëri e kemi futur në planin e integritetit për vitet 2019-2021. Thjesht, konsiderojmë se kemi nevojë që vazhdimisht të mësojmë mbi rreziqet të cilat i kanosen shoqërisë nëpërmjet dukurive negative, që në fakt ndikojnë në imazhin e përgjithshëm të Komunës së Kaçanikut.

PJESA E TRETË, ADMINISTRA E PËRGJITHSHME, KABINETI I KRYETARIT DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Administrata e Përgjithshme

Përveç shërbimeve tjera në nivel qendror të cilat natyrisht për nga natyra e punës secila e luan rolin e rëndësishëm të saj, në nivel lokal administrata e përgjithshme komunale ofron shërbime të ndryshme të parapara me ligje në raport me qytetaret. Të gjitha kërkesat të cilat i drejtohen Komunës së Kaçanikut, procedohen nëpërmjet Qendrës për Shërbime me Qytetar- sektor ky i administratës së përgjithshme. Misioni i këtij sektori është që të gjitha shkresat, kërkesat, vendimet, ankesat etj. të regjistrohen dhe të dërgohen për aty ku janë drejtuar. Ky sektor përpunon në vit mbi 41,000 lëndë dhe rrjedhimisht është i ekspozuar ndaj rreziqeve potenciale që në plan të integritetit e kemi identifikuar si "performancën e dobët të kësaj qendre".

Shkurtesa	Përshkrimi	Totali
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	23,518
DAK	Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës	1,157
DBZHRP	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë	1,024
DEFZH	Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit	6,551
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	209
DESHP	Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike	470
DUKMM	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	6,539
SHK	Shërbimi i Kryetarit	1,656
		41,124

Tab. 2 Raporti sipas departamenteve

Siç mund ta vëreni në tabelë, prej 41,124 lëndëve të cilat janë proceduar për vitin 2018, vetëm 541² janë në proces ende të papërfunduara, duke arritur performancë të lartë me 98.69 %. Gjithashtu mes shërbimeve tjera, Komuna e Kaçanikut nëpërmjet zyrës komunale të gjendjes civile (përfshirë zyret e gjendjes civile në terren), ofron shërbime për qytetarët të gjitha dokumentet të cilat janë të përcaktuar me Ligjin për Gjendjen Civile.

Në përgjithësi obligimi ynë është që të gjithë ata të cilët krijojnë kontakt me Komunën e Kaçanikut nëpërmjet procedurave administrative, tu kthehet përgjigje në afat kohor duke respektuar në perpikmëri ligjet mbi të cilat rregullohen çështjet e ngritura. Synimi ynë ndër tjerash është që ta ngitnim vazhdimisht performancën në shërbimet që iu ofrojmë qytetarëve nëpërmjet bashkëpunimit midis sektorëve të cilët janë pjesë përbërëse e administratës së përgjithshme të Komunës së Kaçanikut.

² Lëndët të cilat janë në proces, në vazhdim të fillim vitit mund të përfundohen ngase disa janë me afate ligjore të rregulluara ashtu. Ky fakt mund ta ngritë përqindjen e performancës. Tabela e datës: 18/01/2019.

Me këto të dhëna të cilat i prezantuar më lartë, dëshmuar se ne jemi mjaft serioz sa i përket realizimit të objektivave dhe planeve që i hartojmë. Gjithashtu qëllimi ynë është që këto plane asnjëherë mos të mbeten vetëm në letër, por të implementohen varësisht kushteve dhe kërkesave që janë paraqitur në to.

Kabineti i Kryetarit

Arritja e koherencës dhe bashkëpunimit midis stafit të kabinetit të cilët zakonisht janë të emëruar politik, por edhe si ekspertë të jashtëm, është forma më e mirë për t'i implementuar politikat zhvillimore lokale.

Me planin e kaluar si fushë të rrezikut kemi paraqitur se "zinxhiri komandues nuk respektohet si dhe mekanizmi i ankesave nuk ekziston". Me qëllim të përmirësimit të zinxhirit komandues, Kryetari i Komunës për vitin 2018, përveç takimeve të rregullta javore (ditëve të hëna), ka aplikuar takimet ditore (çdo ditë nga ora 08.15) me qëllim që të ngritet kontrolli, të shpërndahen përgjegjësitë si dhe të mënjanojen situatat kur nuk përcillen detyrat tek zyrtarët tjerë. Gjithashtu, është ngritur komisioni për shqyrtimin dhe hapjen e kutive të ankesave që vijnë nga qytetarët dhe në baze të vendimit ky komision gjatë vitit 2018, ka raportuar vazhdimisht te Kryetari i Komunës.

Unifikimi i kabinetit të Kryetarit të Komunës me një qëllim të vetëm që është zhvillimi, janë arritur rezultate mjaft të mira sidomos në menaxhimin e projekteve kapitale.

Me marrjen e mandatit të ri, Kryetari i Komunës është përkujdesur që pjesë e kabinetit të tij të jenë persona adekuat, profesional dhe të pranueshëm për masën. Në këtë kontekst, është krijuar ambient i favorshëm i punës ku gjithsecilit iu ndahen përgjegjësitë dhe se të gjithë janë të gatshëm ti ndihmojnë njeri-tjetrit në arritjen e objektivave të cilat i cakton Kryetari.

Bashkëpunimi në mes të pjesëtarëve të kabinetit të Kryetarit me pjesën tjetër të shërbimit civil, për vitin 2018, ka dhënë rezultatet e veta. Është ngritur performanca e përgjithshme e komunës, janë dëgjuar kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, janë aplikuar masa të nevojshme në ngritjen e cilësisë së shërbimeve etj. Me fjalë tjera, kabineti i Kryetarit është i obliguar që të funksionojë si trup unik, me qëllimin e vetëm që zhvillimi i politikave lokale të jetë në harmoni me kërkesat e qytetarëve, dhe si të tilla t'i përgjigjen atyre në çdo kohë. Në anën tjetër, delegimi i kompetencave tek stafi mbështetës, në këtë rast te drejtorët e drejtorive komunale, është mëse i nevojshëm sepse rritë performancën e drejtorive dhe njëkohësisht rritë efikasitetin në zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

Marrëdhëniet me Publikun

Qeverisja e mirë nënkupton pjesëmarrje qytetare dhe vendimmarrje transparente. Komuna e Kaçanikut kujdeset maksimalisht që të përmbushë këto standarde, e vetëdijshme se vendimmarrja transparente e rrit besueshmërinë e qytetarëve te qeverisja lokale.

Edhe gjatë vitit 2018 transparenca dhe llogaridhënia ishin prioritet të punës dhe aktiviteteve komunale me qëllim të fuqizimit të organeve të komunës për informim të

qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit si dhe publikimin e dokumenteve të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Në fund të muajit shkurt të vitit 2018, ka filluar së punuari ueb faqja e re e Komunës së Kaçanikut (projekt i MAP), me qëllim të gjithëpërfshirës dhe krijimit të një sistemi të njëjtë informues për të gjitha komunat e Kosovës. Kështu marrëdhëniet me publikun nëpërmjet zyrës së informimit dhe e IT-së gjatë tërë vitit ka bartur dokumentet nga faqja e vjetër tek faqja e re, me qëllim të lehtësimit të procedurave të kërkimit të informacioneve të nevojshme nga ana e qytetarëve. Gjatë këtij viti të gjitha aktivitetet dhe dokumentet publike, ishin transparente dhe të qasshme për publikun sipas afateve të caktuara ligjore, tashmë në ueb-faqen e re.

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit Komunal të Kaçanikut dhe të Komiteteve të tij, ishin të hapura për publikun. Ato janë paralajmëruar me kohë nga ana e sekretarisë së Kuvendit, ndërkaq nga ana e zyrtarëve për informim, në të njëjtën kohë janë publikuar në ueb-faqen zyrtare dhe në faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut në rrjetin social "Facebook". Pas përfundimit të mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve, Zyra për Informim ka përgatitur informatën duke e publikuar në ueb-faqe të Komunës, si dhe ka publikuar teleprezencën dhe video incizimin e tërë seancës së Kuvendit.

Nëpërmjet këtyre mekanizmave që i përmendëm më lartë, kemi arritur që të krijojmë forma të mira dhe efikase në raport me publikun dhe mbi këtë parim jemi zotuar se do të vazhdojmë t'i përmirësojmë në mënyrë graduale raportet me publikun në formë të vazhdueshme.

Përfundim

Plani i integritetit për vitin 2016-2019, qëllimin kryesor e ka pasur identifikimin e rreziqeve të cilat mund të shkaktoreshin dhe rrjedhimisht të dëmtohej imazhi i Komunës- në këtë rast integriteti i saj.

Që nga 2016 deri 2018, është punuar në mënyrë konkrete me problemet të cilat janë identifikuar gjatë punës tonë por edhe nga ankesat të ndryshme të qytetarëve të Kaçanikut.

Viti 2018, konsiderohet viti me i suksesshëm në raport me integritetin komunal, sepse gjatë kësaj periudhe nuk ka ndodhur asnjë shkelje e rënde në të gjitha segmentet të cilat i kemi ndarë në tri pjesë. Në fakt, këto fusha janë më të rëndësishmet për sa i përket integritetit dhe si të tilla meritojnë tretmanin e duhur.

Për shkak të rëndësisë që i kemi dhënë imazhit të komunës, në dhjetor të vitit 2018, kemi ri-dizajnuar planin e integritetit dhe këtë radhë e kemi hedhur në Kuvend për miratim. Kjo ka ndodhur për të treguar qytetarëve të Komunës së Kaçanikut se ne jemi të prirur t'i vazhdojmë reformat në administratë publike. Misioni është shndërrimi i administratës në institucion modern me anë të së cilës do ta përmbushnim agjendën evropiane konform direktivave që dalin nga Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Ky dokument, shërben si informim për Kuvendin Komunal, se ekzekutivi i komunës është i vendosur që t'i qoj proceset bashkërisht përpara dhe njëkohësisht ju behet

thirrje nga Kryetari i Komunës së Kaçanikut për të bashkëpunuar për çështje të interesit të përgjithshëm, ku do të merrnin pjesë qytetarët, shoqëria civile dhe grupet e caktuara të interesit me qëllim të forcimit të Komunës në rrafshin e integritetit.

KAÇANIKU

